VENDIM
Nr. 492, datë 26.7.2018

PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË RREGULLIMIT TË AKTIVITETEVE TË NISMËS "AKADEMIA 100 + FSHATRAT", NË ZBATIM TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË ZHVILLIMIT RURAL ME FOKUS 100 + FSHATRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "a" e "c", të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME DHE PËRKUFIZIME

1. Ky vendim rregullon organizimin e aktiviteteve të nismës "Akademia 100 + fshatrat", marrëdhëniet institucionale me universitetet, rregullat bazë për bashkëpunimin për ofrimin e shërbimeve të pritshme nga universitetet, në kuadër të zbatimit të memorandumeve të mirëkuptimit të nënshkruara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe institucionet e arsimit të lartë.

2. "Akademia 100 + fshatrat" është një nismë me një seri aktivitetesh që kanë si objektiv kryesor hartimin e modeleve të zhvillimit për secilin prej 100 + fshatrave dhe që kryhen në zbatim të Programit Kombëtar të Zhvillimit Rural, me fokus 100 + fshatrat dhe në vijim të nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit.

3. "Agjencia", termi i përdorur në këtë vendim, i cili ka të njëjtin kuptim me përkufizimin "Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)", sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar.

4. "Universitet", institucion i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale.

II. INSTITUCIONET E PËRFSHIRA DHE AKTIVITETET E NISMËS "AKADEMIA 100 + FSHATRAT"

1. Seria e aktiviteteve të nismës "Akademia 100 + fshatrat" organizohet në bazë të urdhrit të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, në përputhje me nenin 9, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar.

2. Për organizimin e serisë së aktiviteteve të nismës "Akademia 100 + fshatrat" ofrojnë mbështetje institucionet qendrore e vendore, si më poshtë:

a) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

b) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

c) Ministria e Kulturës;

ç) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

d) Strukturat pranë bashkive përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, turizmin, dhe strukturat organizative në nivel njësie administrative e fshati;

dh) Strukturat e agjencive të zhvillimit rajonal.

3. Skema e organizimit të aktiviteteve dhe kalendari i aktiviteteve të nismës "Akademia 100 + fshatrat" miratohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

4. Seria e aktiviteteve përfshin:

a) Identifikimin e udhëheqësve rajonalë në bashkëpunim me universitetet dhe fakultetet, me të cilat janë nënshkruar më parë memorandumet e mirëkuptimit;

b) Hartimin e termave të referencës të detajuara për grupet e punës nga Agjencia;

c) Vizitat në fshatra;

ç) Realizimin e konsultimeve me komunitetin;

d) Hartimin e planeve të zhvillimit territorial dhe modeleve të zhvillimit ekonomik për 100 + fshatrat, sipas termave të referencës;

dh) Zhvillimin e mbledhjeve të punës, me pjesëmarrje të gjerë;

e) zhvillimin e aktiviteteve publike informuese.

5. Nëpërmjet aktiviteteve të nismës "Akademia 100 + fshatrat" përftohen:

a) Planet e zhvillimit territorial dhe modelet e zhvillimit ekonomik për 100 + fshatrat, pjesë e Programit Kombëtar të Zhvillimit Rural;

b) Ide, plane biznesi dhe projekte për nxitjen e zhvillimit të 100 + fshatrave, të cilat mund të kthehen në

projekte zbatimi për t'u investuar nga burime të ndryshme si publike, private, të donatorëve apo kombinimi i tyre;

c) Dije të shtuara për 100 + fshatrat, të cilat do t'u përcillen institucioneve vendore e qendrore për t'u përdorur më tej në aktivitetin e tyre.

6. Nëpërmjet aktiviteteve të nismës "Akademia 100 + fshatrat" mundësohet:

a) Shkëmbimi i njohurive dhe dijes me komunitetet e 100 + fshatrave, sa i përket potencialeve dhe mënyrave për zhvillimin e tyre;

b) Planifikimi me pjesëmarrje të gjerë.

III. KRITERET PËR FORMIMIN E GRUPIT TË PUNËS, PËRZGJEDHJA DHE MËNYRA E SHPËRBLIMIT

1. Drejtuesi i grupit të punës duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë:

a) Të jetë pjesë e stafit akademik të universitetit me të cilin është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit, me kohë të plotë apo të pjesshme, me aftësi drejtuese të spikatura;

b) T'i përkasë njërës prej fushave si arkitekturë, urbanistikë, planifikim territori, planifikim mjedisor, zhvillim rural;

c) Të jetë rekomanduar nga niveli më i lartë i institucionit me të cilin është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit (nënshkruesi);

ç) Të jetë i disponueshëm për angazhim të plotë gjatë vizitave në terren dhe punës në qytetin e Tiranës, për të drejtuar grupin e punës, sipas kalendarit të punës.

2. Asistenti i grupit të punës duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë:

a) Të jetë diplomuar pranë universitetit me të cilin është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit, me rezultate të larta dhe aftësi komunikuese e organizative;

b) T'i përkasë njërës prej fushave si arkitekturë, urbanistikë, planifikim territori, planifikim mjedisor, zhvillim rural;

c) Të jetë pranuar nga niveli më i lartë i institucionit me të cilin është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit (nënshkruesi);

ç) Të jetë i disponueshëm për angazhim të plotë gjatë vizitave në terren dhe punës në qytetin e Tiranës, për të asistuar punën e grupit të punës, sipas kalendarit përkatës.

3. Anëtarët e grupit të punës duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) Të jenë studentë të universitetit me të cilin është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit, me rezultate të larta dhe aftësi të spikatura në fushën e studimeve;

b) T'i përkasin njërës prej fushave si arkitekturë, urbanistikë, planifikim territori, planifikim mjedisor, zhvillim rural;

c) Të jenë të disponueshëm për angazhim të plotë gjatë vizitave në terren dhe punës në qytetin e Tiranës, për të asistuar punën e grupit të punës, sipas kalendarit përkatës.

4. Përpunuesi grafik i grupit të punës duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Të jetë student apo i diplomuar i universitetit me të cilin është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit, me aftësi të larta në komunikim dhe krijimtari grafike;

b) Të jetë i disponueshëm për t'u angazhuar sipas kalendarit të punës dhe kërkesave të grupit të punës.

5. Udhëheqësit rajonalë duhet të plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:

a) Të jenë pjesë e stafit akademik të universitetit me të cilin është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit, me kohë të plotë apo të pjesshme, me njohje të thella akademike dhe praktike;

b) T'i përkasin njërës prej fushave si arkitekturë, urbanistikë, planifikim territori, ekonomi, ekonomi agrare, turizëm, agroturizëm, mjedis, agromjedis, trashëgimi, sociologji etj., fusha që lidhen me zhvillimin rural;

c) Të jenë rekomanduar nga niveli më i lartë i institucionit me të cilin është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit (nënshkruesi);

ç) Të jenë të disponueshëm për t'u angazhuar sipas kalendarit të mbledhjeve të punës dhe takimeve.

6. Detyrat e drejtuesit, asistentit, anëtarëve, përpunuesit grafik të grupit të punës, si dhe udhëheqësit rajonalë përcaktohen në kontratat e bashkëpunimit.

7. Shpenzimet për aktivitetet e nismës "Akademia 100 + fshatrat" mbulohen brenda buxhetit të miratuar për Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

8. Aktivitetet që përballohen nga buxheti i Agjencisë, janë:

a) Aktivitetet e logjistikës;

b) Dietat ditore për punën jashtë qendrës së banimit;

c) Honorare për pozicionet e listuara në pikat 1, 2, 4 e 5, të këtij kreu.

Për zbatimin e aktiviteteve të nismës "Akademia 100 + fshatrat", Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit mundëson angazhimin e grupit të punës dhe të udhëheqësve rajonalë duke lidhur tipat e kontratave,

si më poshtë:

a) Kontratë bashkëpunimi për drejtuesin e grupit të punës;

b) Kontratë bashkëpunimi për asistentin e grupit të punës;

c) Kontratë bashkëpunimi për përpunuesin grafik;

ç) Kontratë bashkëpnimi për udhëheqësin rajonal.

10. Masa e pagesës përcaktohet në kontratë dhe llogaritet në varësi të rolit, sipas pikave 1, 2, 4 e 5, të këtij kreu, si dhe të kohës së angazhimit në aktivitetet e nismës "Akademia 100 + fshatrat". Për kontratat e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", të pikës 9, të këtij kreu, masa e pagesës do të jetë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Përjashtohen nga kjo masë pagese anëtarët e grupit të punës (studentët e përcaktuar në pikën 3, të kreut III, të këtij vendimi).

11. Shpenzimet për udhëtime dhe dieta mbulohen nga buxheti i miratuar për AKPT-në, referuar përcaktimeve të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim, jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar.

12. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

MASAT E PAGESAVE
PËR GRUPIN E PUNËS DHE UDHËHEQËSIT RAJONALË

	Roli	Njësia kohore	Sasia kohore/ person	Masa e pagesës
1	Drejtues grupi*	ditë pune	105	5, 000 lekë
2	Asistent grupi*	ditë pune	105	3, 500 lekë
3	Përpunues grafik*	ditë pune	60	3, 500 lekë
4	Udhëheqës rajonal*	ditë pune	10	10, 000 lekë

*Numri i personave për çdo rol, do të përcaktohet nga nevojat e Akademisë dhe buxheti i institucionit në dispozicion të Akademisë.